

PANAIR PËR EDUKIM, TRAJNIM DHE PUNËSIM NË VLORË, SHKODËR, TIRANË

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Drejtave të Fëmijëve, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët ka zhvilluar **një sërë aktivitetesh që kanë bërë së bashku fëmijë, institucione shtetërore dhe donatorë, palët e interesit për mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të fëmijëve.** Në shkollën "Servete Maçi", Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët zhvilloi një aktivitet me nxënës dhe fëmijë pjesë e programeve të ndryshme, të cilët me anë të talentit të tyre në pikturë shprehën të gjithë së bashku të drejtat që gëzojnë dhe rëndësinë e respektimit të tyre për një jetesë të qëndrueshme larg fenomeneve negative që mund të çojnë procesin e zhvillimit të tyre. Aktivitetet u zhvendosën në Europe House me **një grup fëmijësh që mësuan rreth barazisë sociale, diversitetit dhe gjithëpërfshirjes me anë të librit "Arti i barabartë",** financuar nga Bashkimi Evropian në Shqipëri në kuadër të projektit "BE për Përfshirjen Sociale".



Dita Ndërkombëtare e Drejtave të Fëmijëve u përmbyll me **nënshkrimin e Paktit Kombëtar Kundër Dhunës Seksuale ndaj Fëmijëve në Shqipëri,** ndërmjet 3 ministrive: Ministria e Brendshme, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, së bashku me CRCA dhe ALO 116 111. Në këtë Pakt, parashikohet forcimi i bashkëpunimit, shkëmbimit të informacionit dhe koordinimit për të luftuar dhe mbrojtur fëmijët nga çdo formë e dhunës dhe shfrytëzimit, raportimin e çdo incidenti dhe faqeje të rrezikshme për fëmijët, përmirësimin e politikave, planeve të veprimit, standarteve dhe protokolleve të mbrojtjes së fëmijëve.

KONSTITUIMI I KËSHILLIT TË DYTË KOMBËTAR TË RINISË



Në muajin nëntor 2023 u konstitua Këshilli i Dytë Kombëtar i Rinisë, me anë të së cilit qindra organizata dhe mijëra të rinj votuan për të përzgjedhur përfaqësuesit e tyre në Këshillin Kombëtar të Rinisë.

Më datë 14 nëntor u mbajt mbledhja e parë e Këshillit të dytë Kombëtar të Rinisë, gjatë së cilës u përzgjedh me votim të hapur si zëvendëskryetare Loreta Çermeli nga këshillat studentorë, si dhe u ndanë detyrat e gjithësecilit për dy vitet e ardhshme. Më tej, u diskutua mbi ndërveprimin që anëtarët e Këshillit Kombëtar të Rinisë duhet të kenë me Këshillat Vendorë Rinorë, si edhe rreth shpalljes së thirrjes për infrastrukturë rinore për njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Këshilli Kombëtar i Rinisë, i cili **funksionon si një organ këshillimor pranë ministrit përgjegjës për rininë, përbëhet nga 16 anëtarë,** Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët në rolin e kryetarit, Drejtori i Agjencisë Kombëtare të Rinisë, 8 anëtarë përfaqësues nga organizatat rinore: Borjana Dine, Jesmina Sengla, Klajdi Priska, Klara Kodra, Orjana Çekrezi, Vasilika Laska, Vjera Çurçija dhe Xhulian Kafexhiu; 4 anëtarë përfaqësues nga këshillat studentorë: Elsa Rustaj, Erik Sulaj, Loreta Çermeli dhe Stelina Ndreu dhe 2 anëtarë përfaqësues nga AMVV.

PANAIRI I EDUKIMIT, TRAJNIMIT DHE PUNËSIMIT – EDICIONI KORÇË

Më 24 Nëntor, në kuadër të qëllimit të dytë të Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029, mbështetet dhe nxitet novacioni rinor dhe rritja e aftësive dhe profesionalizmit të të rejave dhe të rinjve përmes edukimit cilësor në TIK dhe fusha të tjera të zhvillimit digjital duke rritur dhe përmirësuar kështu mundësitë për të hyrë në tregun e punës dhe në vijim të nismës "Panair edukimi, trajnimi dhe punësimi në çdo qark", **Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët ka zhvilluar panairin e radhës në qytetin e Korçës**, me qëllim informimin e të rinjve në këto drejtime dhe për t'ju mundësuar atyre një kalim më të lehtë në tregun e punës.

Mbi 30 aktorë që ofrojnë shërbime për të rinjtë, i njohën ata me mundësitë lokale dhe kombëtare për edukim të mëtejshëm, trajnime dhe punësim.



Një javë më parë, në Korçë u zhvillua gjithashtu "Career Tech", panairi i teknologjisë që bëri bashkë aktorë nga e gjithë Shqipëria për të njohur të rinjtë e Korçës dhe zonave përreth me shërbimet e tyre teknologjike. **Gjatë panairit të rinjtë u njohën edhe me Programin e Kodimit me mbështetje financiare nga qeveria, i cili deri më tani numëron mbi 1100 kodues, 45 prej të cilëve janë diplomuar në Korçë.**

SAMITI I TRETË I DIASPORËS – PANELI I DISKUTIMIT "RINI PA KUFIJ"

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, në kuadër të Samitit të tretë të Diasporës organizoi panelin "Rini pa kufij", me të ftuar të rinj nga diaspora dhe të rinj të kthyer në Shqipëri pas shumë vitesh jashtë trojeve shqiptare. Nën moderimin e Alketa Doçi, ish-volejbolliste profesionale e skuadrës "Dinamo" dhe Kombëtares Shqiptare, tashmë koordinatore e projektit "Ekipet Sportive në Shkollë", të ftuarit, Arbër Gashi, Erblina Shehu, Klevis Mino, Rea Tresa, Uarda Begaj, Theodhora Dralo dhe Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, ndanë me të pranishmit eksperiencën e tyre disa vjeçare të studimeve dhe punësimit jashtë vendit, si dhe kontributet që japin për vendin e tyre ndonëse jashtë Shqipërisë. Përsa i përket panelistëve të kthyer në Shqipëri, për të vijuar jetën dhe karrierën në vendin e tyre, ndanë edhe arsyet e kthimit ku kryeson malli për atdheun dhe potenciali që Shqipëria ka për t'u zhvilluar duke u krijuar kështu një ekosistem të qëndrueshëm për zhvillimin e ndërmarrjeve të tyre.





RAPORTIME NË KOMISIONE MBI PROJEKT-BUXHETIN E VITIT 2024 PËR RININË.

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët përgjatë muajit nëntor ka raportuar në Komisionin e Punëve, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë, dhe në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik mbi projekt-buxhetin e vitit 2024 për rininë, duke prezantuar një panoramë të detajuar mbi planet për projekt-buxhetin 2024 bazuar në Strategjinë Kombëtare të Rinisë 2022-2029. Gjatë raportimit, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët u fokusua në rritjen prej 33% të buxhetit për rininë dhe impaktin pozitiv që ai ka duke krijuar kështu mundësitë që të rinjtë të përfshihen në më shumë aktivitete dhe projekte rinore që fuqizojnë zërin dhe aftësitë e tyre, si dhe rrisin mirëqenien psikologjike dhe sociale.

MBAHET FORUMI RINOR NË BARCELONË ME TEMËN "ANGAZHIMI RINOR PËR NJË MESHKE MË TË QËNDRUESHËM DHE GJITHËPËRFSHIRËS"

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët mori pjesë në Forumin Rinor në Barcelonë, organizuar nga Bashkimi për Mesdheun me temën "Angazhimi rinor për një Mesdhe më të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës". Në sesionin hapës, krahas Sekretarit të Përgjithshëm për Bashkimin me Mesdheun, **Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët ndau eksperiencën lidhur me Strategjinë Kombëtare të Rinisë 2022-2029 dhe përfshirjen e vetë të rinjve në hartimin dhe vlerësimin e strategjisë**, duke u ndalur dhe në strukturat e ngritura për fuqizimin e vazhdueshëm të të rinjve shqiptarë, specifiksht në Këshillat Vendorë Rinorë dhe Këshillin Kombëtar të Rinisë dhe më pas në programet për përmirësimin e aftësive të tyre dhe ndërlidhjen me tregun e punës. Gjithashtu, gjatë këtij forumi, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët zhvilloi takime bilaterale me Sekretarin e Përgjithshëm të Bashkimit për Mesdheun, me delegacionin egjiptian që drejtohej nga Zëvendësministri i Rinisë dhe Sportit, së bashku me përfaqësues të tjerë qeveritarë dhe përfaqësi të organizatave rinore.

